

BASHKËPUNËTORI I ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT:

Analizë arkivore dhe metodologjike

Msc.Mirela Murrizi

(AIDSSH)

BIO

Znj. Mirela Murrizi është juriste, e diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë dhe zotëron titullin Master i Shkencave në Shkencat Juridike. Ka një përvojë profesionale prej 28 vitesh në institucione të ndryshme publike. Prej tre vitesh ushtron detyrën e Specialistes në Drejtorinë e Informacionit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ku merret me përpunimin, analizën dhe interpretimin e dokumentacionit arkivor. Interesat e saj kërkimore përqendrohen në studimin e burimeve arkivore, metodologjinë e kërkimit dokumentar, si dhe analizën historiko-juridike të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, me fokus në rolin dhe funksionimin e rrjetit informativ gjatë regjimit komunist.

Abstrakt

Ky punim trajton mekanizmat e rekrutimit dhe organizimit të rrjetit bashkëpunëtor të ish-Sigurimit të Shtetit gjatë periudhës komuniste në Shqipëri (1944–1991). Studimi mbështetet në analizën e dokumenteve arkivore, rregulloreve operative dhe platformave të punës së organeve të Sigurimit të Shtetit. Në fokus të punimit janë kategoritë e bashkëpunëtorëve, si rezidenti, agjenti, informatori dhe strehuesi, si pjesë e strukturës së survejimit dhe kontrollit politik. Punimi analizon mënyrat e rekrutimit të individëve në bashkëpunim, duke evidentuar dallimin ndërmjet rekrutimit në baza vullnetare dhe patriotike dhe atij të realizuar përmes detyrimit dhe shtrëngimit. Dokumentacioni arkivor tregon se procesi i rekrutimit ishte i organizuar dhe i studiuar në mënyrë të detajuar nga organet operative. Në analizë evidentohe përdorimi i biografisë, cënueshmërisë personale, presionit psikologjik dhe propagandës ideologjike si instrumente për sigurimin e bashkëpunimit. Studimi trajton gjithashtu mekanizmat e kontrollit operacional, ruajtjen e konspiracionit dhe mënyrën e funksionimit të rrjetit informativ. Një rëndësi e veçantë i kushtohet ndikimit që ky sistem pati në marrëdhëniet shoqërore dhe në krijimin e klimës së frikës dhe mosbesimit në shoqërinë shqiptare. Punimi synon të kontribuojë në kuptimin historik dhe institucional të funksionimit të aparatit represiv të regjimit komunist. Në përfundim, studimi evidenton se rrjeti bashkëpunëtor përbënte një nga instrumentet kryesore të kontrollit politik dhe survejimit të shoqërisë shqiptare gjatë diktaturës komuniste.

Fjalë kyçe: *bashkëpunëtor, dokumente arkivore, Sigurimi i Shtetit, përpunimi operativ, raport, survejim, plane masash.*